

Dy të lënduar nga të shtënat me armë në Prishtinë

LAJME



21/11/2024 17:00



Disa të shtëna me armë janë dëgjuar në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë ditën e sotme rreth orës 16:00, si pasojë e të cilave kanë mbetur të lënduar dy persona.


Policia për lajmi.net ka konfirmuar se rasti ka ndodhur saktësisht në rrugën "Mon Balaj".

Zëdhënësi i Policisë për rajonin e Prishtinës, Agron Borovci , ka thënë për lajmi.net se nga rasti lëndime kanë pësuar dy persona, të cilët pastaj janë dërguar për trajtim në QKUK.

Rreth orës 16:00, është raportuar për të shtëna me armë zjarri në rrugën "Mon Balaj" në Prishtinë. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes dhe nga informacionet e para është bërë e ditur se dy persona kanë marrë lëndime dhe të njëjtit janë dërguar në QKUK për trajtimin e nevojshëm mjekësor. Policia në mënyrë aktive po vijon punën e saj me veprime të ekzaminimit të vendngjarjes si dhe me veprime të tjera operativo-hetimore, me qëllim të sqarimit të rrethanave që karakterizojnë ngjarjen si dhe identifikimin, lokalizimin dhe kapjen e personave që dyshohet të jenë të përfshirë në rastin në fjalë", thuhet në konfirmimin e Policisë./Lajmi.net

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



November 21, 2024

Kurti: USAID na ka mbështetur në reformat e qeverisë



November 21, 2024

Incidenti me armë zjarri në Prishtinë, Arifi: Siguria publike çdo ditë...




November 21, 2024

Incidenti në Kodrën e Trimave- Policia shihet edhe në QKUK, po...




November 21, 2024

Mushkolaj: Serbia me shumë mund e ka penguar Asociacionin



November 21, 2024

SHBA vendos sanksione të reja kundër Rusisë



November 21, 2024

Policia e Kosovës demanton shkrimet e mediave serbe mbi shkeljen e...